

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 378 DATË 05.06.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK PËR PAJISJET RADIO, NJOHJEN E NDËRSJELLË TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT TË TYRE DHE PËRCAKTIMI I LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA”

I. QËLLIMI I PROJEKAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.378, datë 05.06.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimi i listës së standardeve të harmonizuara”, është propozim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të nenit 5 pika 2, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, si dhe të pikës 3 të nenit 79 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rregulli teknik që zbatohet për pajisjet radio përcakton kërkesat thelbësore në veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe vënies në shërbim të pajisjeve radio në Republikën e Shqipërisë bazuar në Direktivën 2014/53/EU, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve radio. Rregulli teknik i miratuar me VKM nr. 378 datë 05.06.2019 zbatohet për të gjitha pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri.

Direktiva 2014/53/EU, që është transpozuar në VKM Nr. 378 datë 05.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimi i listës së standardeve të harmonizuara”, është ndryshuar me Direktivën (EU) 2022/2380, e cila parashikon rregullime shtesë në lidhje me pajisjet radio në disa kategori ose klasa, në veçanti lidhur me pajisjet e karikimit të tyre.

Projektakti synon të bëjë plotësime në një nga kërkesat thelbësore që pajisja radio duhet të përmbushë, në lidhje me ndërveprimin me aksesorët, veçanërisht

me karikues të zakonshëm, me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë ndërmjet pajisjeve radio, dhe për të thjeshtuar përdorimin e tyre në të mirë të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë dhe reduktuar mbetjet dhe kostot e panevojshme.

Projektakti ka si qëllim ndërmjet të tjerash që të reduktojë mbetjet elektronike të krijuara nga shitja e pajisjeve radio, dhe në reduktimin e nxjerrjes së lëndëve të para dhe emetimeve të CO2 të gjeneruara nga prodhimi, transporti dhe asgjësimi i karikuesve, duke promovuar kështu një ekonomi ricikluese. Ai vjen si nevojë e përditësimit të rregullave teknike për pajisjet radio dhe harmonizimit më të mirë të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektvendimi, është parashikuar në Programin Analitik të Akteve, të miratuar për vitin 2023 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe gjithashtu në Planin Kombëtar për Integrimin European në kapitullin 1: “Lëvizja e lirë e mallrave”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me VKM nr. 378 datë 05.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimi i listës së standardeve të harmonizuara” janë miratuar kërkesat thelbësore për pajisjet radio në zbatim të parashikimeve në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, si dhe ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Rregulli teknik për pajisjet radio ka transpozuar Direktivën 2014/53/EU, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve radio e cila ka ndryshuar në vitin 2022.

Në procesin e screening të kapitullit 1, “Lëvizja e lirë e mallrave”, është rekomanduar amendimi i rregullit teknik të miratuar me VKM nr.378 datë 05.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimi i listës së standardeve të harmonizuara”, me qëllim harmonizim më të mirë me direktivën

e BE-së. Projektakti i ri përfshin disa shtesa në kërkesat thelbësore për pajisjet radio të miratuara me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe bën harmonizim me direktivën e ndryshuar të BE-së.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 2, dhe 42 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, si dhe të pikës 3 të nenit 79 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi përafron Direktivën (BE) 2022/2380 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 23 nëntor 2022, që ndryshon Direktivën 2014/53/BE për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të pajisjeve radio.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt Vendimi i Këshillit të Ministrave përmban 5 pika:

- Në pikën I, përcaktohet se Në tekstin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjelltë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
- Në nenin 1, propozohet që në nenin 3, të ndryshohet shkronja “a)”, duke parashikuar pajisjet radio që ndërveprojnë me aksesore të ndryshëm, si dhe specifikimin e kategorive ose klasave të pajisjeve radio, në një Aneks të ri I/1. Gjithashtu në këtë pikë propozohet të shtohen pikat 5 deri në 13, të cilat përfshijnë rregulla që duhet të plotësojnë pajisjet radio brenda kategorive ose klasës së specifikuar lidhur me aftësitë e karikimit që të sigurojnë ndërveprueshmërinë. Është parashikuar gjithashtu që të bëhet një vlerësim i vijueshëm për zhvillimet e tregut, si dhe një rishikim periodik për pajisjet radio që specifikohen në aneks.
- Në nenin 2, propozohet të shtohet një nen i ri, 3/1, lidhur me pajisjet radio pa pajisje karikimi në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 1, të

Direktivës (EU) 2022/2380. Me anë të këtij neni kërkohet që kur një operator ekonomik u ofron konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, mundësinë për të blerë pajisje radio, së bashku me një pajisje karikimi, ai duhet t'i ofrojë gjithashtu konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë fundorë, mundësinë e marrjes së asaj pajisjeje radio pa pajisje karikimi. Gjithashtu parashikohet detyrimi për dhënien e informacionit në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme dhe, në rastin e shitjes në distancë.

- Në nenet 3, 4, 5 me të cilat bëhet harmonizimi me pikat 3, 4, dhe 5, të nenit 1, të Direktivës (EU) 2022/2380, propozohet të shtohet nga një pikë përkatësisht në nenet 10, 12, dhe 13, me qëllim parashikimin e rregullave për operatorët ekonomike, importuesit, për udhëzimet, etiketat e pajisjeve radio që bien në kategoritë apo klasave të specifikuar në aneksin e shtuar, mbi specifikimet për aftësitë e karikimit të pajisjeve radio dhe pajisjet karikuese të përshtatshme, mënyrën e prezantimit të tyre për një mbrojtje sa më të mirë të konsumatorit, përdoruesit.
- Në nenin 6, bëhet një plotësim në parashikimin e pikës 1, të nenit 17, që reflekton ndryshimet e propozuara në nenin 3, të rregullit teknik.
- Në nenin 7, propozohet të bëhet një riformulim në pikën 3, të nenit 21, ku në vend të formulimit: “do të jetë në gjuhën shqipe”, zëvendësohen me fjalët: “do të jetë në gjuhën zyrtare të vendit ku organi i miratuar/notifikuar është krijuar ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga organi i miratuar/notifikuar”. Riformulimi i kësaj pike është rekomanduar nga ekspertët gjatë procesit të *screening* të Kapitullit 1, “Levizja e lire e mallrave” me qëllim heqjen e kufizimit në formulimit ekzistues.
- Në nenin 8, propozohen ndryshime në nenin 35, të rregullit teknik duke riformuluar titullin e nenit si dhe, një plotësim në pikën 1, të këtij neni ku pas fjalëve “..për aspektet e mbrojtjes së interesit publik” shtohen fjalët: “ose që nuk përputhen me të paktën një nga kërkesat thelbësore të zbatueshme sic përcaktohet në nenin 3,”.
- Në nenin 9, propozohet të ndryshohet pika 1 e nenit 38 të rregullit teknik ku shtohen disa pika lidhur me kërkesat për piktogramën dhe etiketat e pajisjes radio, që reflektojnë plotësimet që bëhen me nenin e ri 3/1, si dhe me pikat e shtuara 9.1 në nenin 10. Gjithashtu është propozuar një riformulim për shkronjat ë) dhe g), të këtij neni, për harmonizim me ndryshimin e nenit 10.

- Në pikën II parashikohet që masat e parashikuara për kategoritë ose klasat e pajisjeve radio të përcaktuara në pikat 1.1 deri në 1.12, të pjesës së parë të Aneksit I/1, zbatohen duke filluar nga data 1 Janar 2025.
- Në pikën III përcaktohet se masat e parashikuara për kategoritë ose klasat e pajisjeve radio të përcaktuara në pikën 1.13, të pjesës së parë të Aneksit I/1, zbatohen duke filluar nga data 1 korrik 2026.”.
- Në pikën IV parashikohet që pas Aneksit 1 bashkëlidhur vendimit, shtohet Aneksi 1/1, sipas këtij vendimi, që është në harmoni të plotë me aneksin Ia, të direktivës dhe përcakton kategoritë, klasat e pajisjeve radio për të cilat parashikohen rregullat shtesë për karikuesin. Në keto kategori futen pajisjet radio si: telefonat celularë, tabletat, kamerat digjitale, kufjet, kufje me mikrofon, altoparlantët portativë, lexuesit elektronike, tastierat, sistemet portative të navigimit, kufje pa tel, laptopët. Në Aneksin I/1 jepen specifikimet dhe informacionet në lidhje me karikimin të zbatueshme për disa kategori ose klasa të pajisjeve radio.
- Në pikën V përcaktohet që ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti për Komunikimet Elektronike dhe Postare, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga një grup pune në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë pas një konsultimi me Autoritetin për Komunikimet Elektronike dhe Postare dhe Inspektoriatin Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut. Në hartimin e projektaktit është mbajtur parasysh analiza e kryer gjatë procesit screening të Kapitullit 1, “Lëvizja e lirë e mallrave” dhe sugjerimeve të ekspertëve të angazhuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë proces.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit. Ndryshimet që propozohen me këtë projekt akt janë një përditësim i rregullit teknik që ka qenë miratuar me Vendimin nr. 378 datë 05.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimi i listës së standardeve të harmonizuara”.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR**

Belinda Balluku